

VENDIM
Nr.200, datë 22.4.1999

**PËR DISA NDRYSHIME NË PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË PYJORE DHE
POLICISË SË NDËRTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, me propozimin e Ministrisë së Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.185, datë 16.4.1993 “Për pagat dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve të shërbimit pyjor”, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

Drejtor 51 600 lekë

Zëvendësdrejtor 36 850 lekë

b) Në pikën 2, niveli më i ulët i pagës bëhet 6380 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (drejtor drejtorie) bëhet 16 400 lekë në muaj.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.238, datë 16.4.1996 “Për organizimin dhe strukturën e Policisë së Ndërtimit” bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

Drejtor 51 600 lekë

Zëvendësdrejtor 36 850 lekë

b) Në pikën 2, niveli më i ulët i pagës bëhet 6380 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (kryetar dege) bëhet 16 400 lekë në muaj.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara nga Buxheti i Shtetit për vitin 1999.

4. Ky vendim i shtrin efektet e tij financiare nga data 1.5.1999.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko